



ALBGAZ sh.a.

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. 10 Prot

Tiranë, më 22/12/2023

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2022

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.**

ALBGAZ Sh.a

**Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror
Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovareve,
Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri**

www.albgaz.al

NUIS: L71306034U

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2022

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.**

Tiranë, 2023

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAZ Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tij në vitin 2022.

Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE Nr. 171, Datë 16.08.2022 mbi “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a”, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAZ Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@gmail.com

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ sh.a: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

ALBPETROL sh.a: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë”

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

ALBGAZ/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit”

ENTSO-G: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm”

MEDREG: Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

ECRB: Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë

ACER: Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

CEER: Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë

GRI SSE: Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

IGU: Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

OME: Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

UfM: Unioni për Mesdheun

ALPEX: Bursa Shqiptare të Energjisë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

Përmbajtja

PJESA E PARË	6
1. Hyrje.....	6
2. Shoqëria	6
3. Vështrim i Përgjithshëm mbi Sektorin e Energjisë në Vendi tonë për Vitin 2022	9
4. Licencimi në aktivitetet e Gazit Natyror	12
5. Programi i Përputhshmërisë	12
A. Ndarja dhe pavarësia.....	12
1. Ndarja	12
2. Pavarësia drejtuese.....	13
3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse	13
B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese.....	15
1. Akses në sistemin e transmetimit	15
2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale.....	16
3. Konflikti i interesit.....	16
C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ.....	16
1. Sigurimi i informacionit	16
2. Konfidencialiteti i informacionit	17
3. Informacioni publik.....	17
D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë.....	17
PJESA E DYTË	18
4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë	18
PJESA E TRETË	19
6. Detyrat specifike të lëna nga ERE për vitin 2023 dhe objektivat për të ardhmen në sektorin e gazit natyror.	19
PJESA E KATËRT	22
7. Konkluzione.....	22

PJESA E PARË

1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të Programit të Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport. Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin paraprak ERE Nr. 355, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së Albgaz sh.a dhe vendimi nr. 3 datë 01.02.2023 nga Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a “Emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë të shoqërisë Albgaz Sh.a”, Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të pestë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. (ALBGAZ) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të ALBGAZ në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2020 nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAZ me vendim Nr.18, datë 04.11.2020 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar në ERE me vendim nr. 263, datë 28.12.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ‘Albgaz’ sh.a’.

Programi nxjerr një Raport vjetor, i cili bazohet në sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të ALBGAZ ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisht së ALBGAZ, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga ALBGAZ si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës 1.1.2022 – 31.12.2022.

Zyrtari konstantoi që ALBGAZ është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2022 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatohet nga kompania. Gjithashtu përgjatë 2022 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me ALBGAZ kanë bashkëpunuar për të krijuar rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime, dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që kompania dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.

2. Shoqëria

ALBGAZ është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. Selia qendrore e

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu kompania ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

ALBGAZ është certifikuar nga ERE si një **transmetues i kombinuar gazi dhe shpërndarës** me Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 8.11.2017 "Për certifikimin e kompanisë si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror". Me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **shpërndarjes** së gazit natyror, dhe vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **transmetimit** të gazit natyror. Përgjatë vitit 2022, ERE me Vendimi nr.13 datë 26.01.2022 "Mbi kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror".

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016.; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, shqyrtoi relacionin me nr. 128/1 prot., datë 21.01.2022, të përgatitur nga Drejtoritë teknike, me lëndë "Mbi kërkesën e shoqërisë "ALBGAZ" sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE për licencimin e shoqërisë "ALBGAZ" sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror Aktualisht objekti kryesor i aktivitetit të ALBGAZ si një operator i kombinuar, është të ofrojë transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të trasmetimit dhe shpërndarjes, dhe në të ardhmen të ofrojë edhe aktivitetin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror dhe të impiantit të gazit natyror të lëngëzuar.

Në përfundim Bordi i ERE vendosi si vijon:." Të pranojë kërkesën e shoqërisë "Albgaz" sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të Gazit Natyror deri më datë 20.12.2022.

Shoqëria "ALBGAZ" sh.a. duhet të raportojë në ERE çdo tre muaj nga miratimi i këtij vendimi, mbi ecurinë e procesit për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Vendimi nr.14 datë 26.01.2022 "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017,"për licencimin e shoqërisë "Albgaz" sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së Gazit Natyror" (i ndryshuar).

Shoqëria "ALBGAZ" sh.a., me shkresën nr. 93 prot., datë 21.06.2021, protokolluar në ERE me nr. 764 prot., datë 21.06.2021, ka bërë me dije se është pajisur me "Vendim për VNM Paraprake", dokument i depozituar në ERE dhe i nevojshëm për aplikim për paisje me Leje Mjedisore, e cila mbetet në proces për tu marrë gjatë vitit 2022.

Për sa i përket kushtit që ka të bëjë me "Çertifikatën e Sigurimit", shoqëria "ALBGAZ" sh.a. bëri me dije se është parashikuar në buxhetin e saj për vitin 2022 pagesa përkatëse dhe do të mbyllet përgjatë këtij viti.

Shoqëria kërkoi shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit që ka të bëjë me depozitimin në ERE të "Çertifikatës së Sigurimit", në një datë me atë të kushtit të vendosur për depozitimin në ERE të "Lejeve dhe Autorizimeve Mjedisore", pra më datë 20.01.2022.

Në ligjin nr. 44.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në nenin 53, pika 3, citohet se: "Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”

Për sa më sipër, Bordi i ERE miratoi si vijon:

Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së Gazit Natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit.

Vendimi nr.15 datë 26.01.2022 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, “për liçencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të Gazit Natyror” (i ndryshuar).

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi I ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, shqyrtoi relacionin me nr. 128/2 prot., datë 21.01.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Liçencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, me lëndë “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për liçencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të Gazit Natyror, i ndryshuar” për miratimin e ndryshimit të pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, (i ndryshuar), Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. kërkonte shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit që ka të bëjë me depozitimin në ERE të “Çertifikatës së Sigurimit”, në një datë me atë të kushtit të vendosur për depozitimin në ERE të “Lejeve dhe Autorizimeve Mjedisore”.

Në lidhje me shtyrjen e afateve procedurale nga organi publik, ligji nr. 44/2015, në “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 53, pika 3, citohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”

Për sa më sipër, Bordi i ERE vendosi si vijon:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë:

Të liçencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të Gazit Natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE lejet dhe autorizimet mjedisore dhe certifikatën e sigurimit”

Vendimi nr. 17, datë 26.01.2022 “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë” operatori i kombinuar i gazit natyror “Albgaz sh.a”, (i ndryshuar).

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 59, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; ; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 128 prot., datë 21.01.2022 e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”, i ndryshuar”, Bordi I ERE konstatoi se:

Sa i përket kushtit që lidhet me paraqitjen në ERE çdo vit ushtrimor të informacionit mbi pavarësinë e audituesve financiarë vendosur nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 152, datë 30.06.2021, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka paraqitur dokumentacionin respektiv dhe si i tillë ky kusht konsiderohet i plotësuar/përditësuar për vitin 2020 dhe pika 5.1 e vendimit nr. 179/2017 mbetet e pandryshuar.

Për kushtin që lidhet me bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10), i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, shoqëria “Albgaz” sh.a. bën me dije se ka qenë në komunikim të vazhdueshëm shkresor dhe verbal me MIE-n me qëllim përmbushjen e këtij kushti. Po ashtu “Albgaz” sh.a. informon se është pranë arritjes së një zgjidhjeje të gjithëpranuar nga palët, dhe për këtë arsye kërkon nga ERE shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr. 152/2021, deri në datën 20.11.2022.

Bordi i ERE-s, vendosi:-“Të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë

08.11.2017, (të ndryshuar), si më poshtë:“...5.2 Shoqëria “Albgaz” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2022 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

3. Vështrim i Përgjithshëm mbi Sektorin e Energjisë në Vendin tonë për Vitin 2022

Në sektorin e gazit natyror, gjatë vitit 2022, ERE ka miratuar disa akte nënligjore të cilat do të luajnë rol në zhvillimet e pritshme të rrjetit të transmetimit dhe të Shpërndarjes, si dhe janë miratuar edhe aktet nënligjore mjaft të domosdoshme për Terminalin e LNG (Gazit Metan të Lëngëzuar) si dhe aktet e tjera për Ruajtjen nëntokësore të gazit natyror, në kripërat e zonës së Dumresë.

ERE po bashkëpunon me autoritetet e tjera publike për zhvillimin e kuadrit rregullator që do të tërtojë në ndërtimin e tubacionit 30 km nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Topojë, Fier, çkagjykojmë se do të krijojë mundësinë e përshpejtimit të riparimit të TEC-it Vlorë dhe të vendosjes së tij në punë. Tubacioni me gjatësi 30 km nga Vlora në Fier do të krijojë mundësinë që përveç përmbushjes së nevojave tona të mund të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP për nevojat e Rajonit.

Paralelisht ERE po bashkëpunon me Entin Rregullator të Italisë dhe Greqisë për përmirësimin e akteve nënligjore të TAP siç janë: Kodi i rrjetit TAP, Market Testi i vitit 2022 që do të vazhdojë edhe për vitin 2023, i cili do të sjellë rritje të kapacitetit transportues të gazit nga 10 miliard m³gaz në një sasi më të madhe.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

Për vitin 2022, TAP ka transmetuar rreth 12 miliard m³ gas/vit. Kjo na krijon mundësinë që vendi jonë të ketë në dispozicion sasi gazi të mjaftueshme nëpërmjet pikave në Fier dhe Kuçovë.

ERE gjithashtu do të vijojë punën për identifikimin e nevojës dhe kërkesave për gaz si dhe analizës studimore mbi përdoruesit e gazit në vendet e rajonit dhe pritshmëritë për tregun shqiptar. Për këtë studim dhe vlerësimin e skenarëve të parashikuar, ERE do të bazohet në dokumentin strategjik “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018 - 2033”, miratuar me VKM-në nr. 480 datë 31.07.2018, dhe në VKM-në nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”.

Në Nëntor 2022, ALPEX-i zyrtarizoi fillimin e periudhës së trajnimit nëpërmjet platformës së tregtimit për qëllime trajnuese me synim garantimin e një fillimi të sigurtë të Bursës Shqiptare të Energjisë. Ky trajnim do të zgjasë deri në fund të muajit Mars 2023 duke i mundësuar ALPEX-it në rolin e Operatorit të Tregut si edhe anëtarëve të tjerë potencial të tregut të marrin pjesë në një ambient tregtimi për të përfituar njohuritë e duhura që lidhen me mënyrën e ofertimit në tregun e organizuar të si edhe rezultatin e këtij procesi në një mjedis real.

Më 01 Shkurt 2022, ALPEX është pranuar si Anëtar i Asociuar në Shoqatën e Bursave Evropiane të Energjisë (EUROPEX), e cila është një organizatë e rëndësishme në politikë bërjet në fushën e tregtimit të dhe të gazit.

Analizë e tregut për gaz natyror

Në objektivat strategjike të ERE, si dhe nga kalendari i masave të rishikuar, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 20, datë 04.02.2022, Analiza e tregut për gaz natyror, është e ndarë në disa pika:

- (i) Identifikimin e nevojës dhe kërkesave për gaz. Analizë studimore mbi përdoruesit e gazit në vendet e rajonit dhe pritshmëritë për tregun shqiptar.**
- (ii) Studimi i skenarëve për të mundësuar furnizimin me gaz të konsumatorit shqiptar, familjarë ose jo familjarë.**
- (iii) Studimi i Politikave të çmimeve, tarifave.**
- (iv) Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit.**

Për sa i takon vlerësimin e rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënies së rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit, nga ERE janë ndërmarrë disa iniciativa që lidhen me korrespondencën e saj me dy Operatorët kryesorë të sektorit të gazit natyror në Shqipëri. Operatori i kombinuar Albgaz sh.a., dhe TAP AG i cili është një Operator i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe një Operator i Pavarur Transmetimi (OPT), duke i mundësuar transportuesëve të interesuar të gazit natyror në Shqipëri, të transportojnë gaz ofruar shërbim cilësor dhe të sigurve në përputhje me standartet e sigurisë në fuqi.

TAP kontribuon në sigurinë energjetike të Evropës dhe punon me standarde operationale dhe sigurie kombëtare dhe ndërkombëtare dhe që nga data 31 Dhjetor 2020, ka transportuar mbi 15 bcm gaz natyror për në Evropë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në raportin e përmbledhës përsa i takon tregut të gazit në Shqipëri thekson se është e nevojshme ngritja e infrastrukturës funksionale si dhe krijimi i bazave të një tregu të brendshëm gazi funksional në TAP kontribuon në sigurinë energjetike të Evropës vendin tonë.

Sipas raportit, pas funksionalizimit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP AG), Shqipëria është zyrtarisht e lidhur me tregjet e gazit. Shqipëria është kthyer në një vend tranzit, pasi TAP ka filluar operacionet tregtare dhe po kryen një test tregu për zgjerimin e kapaciteteve të tij. Kohët e fundit, Shqipëria ka promovuar një burim furnizimi me bazë LNG për projektin e tij të braktisur prej kohësh të konvertimit të termocentralit (TEC) Vlorë në gaz. Në të njëjtën kohë, synohet të bëhet edhe një rrugë tranziti e LNG-së Italia nëpërmjet TAP-it. Megjithatë, nuk ka përparim në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës së gazit. Gazsjellësi Shqipëri – Kosovë (ALKOGAP) është një projekt me interes për Komunitetin e Energjisë (PECI). Gazsjellësi Jon Adriatik (IAP) është gjithashtu një projekt me interes të ndërsjellë (PMI).

Shoqëria “Albgaz” sh.a. është autoriteti publik që është përgjegjës për transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë dhe administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndërtuar para 40 vitesh, me teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korrozioni janë minimale.

Rrjeti i tubacioneve të gazit është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t'u lidhur me rrjetin. Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në disa vende është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi.

Gjatë vitit 2022, në zbatim të Urdhërit respektiv me nr. 54/2022 është ngritur grupi i punës, me objekt “Monitorimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për zbatimin e planit të investimeve për vitin 2021”. Nga raporti i monitorimit rezultoi se shoqëria ka patur vështirësi në përmbushjen e këtij objekti dhe u konstatua seplani i zhvillimit 10 vjeçar të rrjetit është në shqyrtim nga një shoqëri konsulente e cila pritet të dalë me një version përfundimtar në fund të vitit 2022 deri në fillim të vitit 2023.

Gjithashtu janë zhvilluar takime me perfaqësues të Operatorit të Kombinuar “Albgaz” sh.a. dhe konsulentit, ku u diskutuan problematikat në përgatitjen e dokumentit: Plani i investimeve për 10 vjeçarin e fundit të shoqërisë “Albgaz” sh.a. që lidhet me planin e investimit në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes së Albgaz.

Gjatë vitit 2022 ERE ka patur korrespondencë të vazhdueshme me stafin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për ndjekjen e objektivit për krijimin e një rrjeti të kompletuar dhe adekuat me kërkesat dhe kushtet e vendosura nga dokumentat e marrëveshjeve ndërqeveritare, me qëllim 5-fishimin e gjatësisë së tubacioneve dhe lidhjen e tij me rrjetin ndërkombëtar të gazit në rajon, e cila mbetet një ndër sfidat kryesore edhe për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023 do vijojë korrespondenca dhe bashkëpunimi me shoqërinë “Albgaz” sh.a. për plotësimin e detyrës së caktuar dalë nga konkluzionet e raportit të monitorimit të ERE, për evidentimin e aseteve në terren dhe gjendjen e tyre, si dhe për projektet dhe marrëveshjet që lidhen me krijimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës së Gazit Natyror.

4. Licencimi në aktivitetet e Gazit Natyror

Gjatë vitit 2022, ERE nuk ka realizuar procese të licencimit si dhe nuk ka pasur modifikime të licencave në sektorin e gazit natyror.

5. Programi i Përputhshmërisë

Monitorimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve është bazuar në katër parimet themelore (**ndarja dhe pavarësia, aksesit dhe shpërdarja e informacionit, përjashtimi i sjelljes diskriminuese dhe zbatimi i rregullt i programit**) të programit të përputhshmërisë është miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (Bordi) me Vendim Nr. 171, Datë 16.08.2022 mbi “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAS” sh.a.”, shqyrtohet se si aktiviteti i ALBGAS duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislacioni në fuqi.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ere-s nr. 171, datë 16.08.2021, “për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “albgaz” sh.a.”, i ndryshuar vendosi miratimin përfundimtar të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAS” sh.a., duke lënë detyrën që “ALBGAS” sha të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për sa i përket: marrëdhënieve të aksionerëve të shoqërisë “ALBGAS” sha me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, ose ato që kanë ndonjë interes komercial (pika 5 e Programit të Përputhshmërisë së “ALBGAS” sha) ndarjes dhe pavarësisë së organeve publike të cilat janë të autorizuar të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër (pika 6 e Programit të Përputhshmërisë së “ALBGAS” sha).

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë.

Kërkesat dhe parimet e mëposhtme rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për ALBGAS, dhe çdo strukturë e saj është e detyruar të realizoj dhe kërkojë përputhshmërinë me këto kërkesa dhe parime.

A. Ndarja dhe pavarësia

1. Ndarja

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAS nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”

- **ALBGAS i plotëson kërkesat e programit pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Albgaz sh.a., në përmbushje të konstatimeve që i referohen pikës 5 dhe 6, të Kreut II, të Programit të Përputhshmërisë (Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST) dhe të pikës 15, të Kreut III, që ka të bëjë me ndarjen e pronësisë dhe pavarësinë e OST, Albgaz Sh.a. i ka bërë me dije Entit**

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023” ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të ALBGAZ, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ALBGAZ të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrorjnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të e të gazit natyror dhe veprimtarinë e ALBGAZ ose rrjetit të transmetimit.

2. Pavarësia drejtuese

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”

- duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të ALBGAZ, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësive strukturore), janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në Albgaz sh.a. vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e Albgaz sh.a., siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të Albgaz sh.a. tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i Albgaz sh.a. dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk do mund të paracaktohen që në fillim.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk kanë konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”: **ALBGAZ ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse.** ALBGAZ mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongjestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, ALBGAZ është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. ALBGAZ është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. ALBGAZ mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

Gjatë vitit 2022, për sektorin e gazit natyror, nga ana e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë miratur Vendimet si më poshtë:

Me Vendimin nr. 13, datë 26.01.2022, Bordi i ERE-s vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të vendimarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri më datë 20.12.2022.

Me Vendimin nr. 14, datë 26.01.2022, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë: “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore dhe Certifikatën e Sigurimit.”

Me Vendimin nr. 15, datë 26.01.2022, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë ndryshimin e pikës 1, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar si më poshtë: “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 21.12.2022, të depozitojë në ERE Lejet dhe Autorizimet Mjedisore dhe Certifikatën e Sigurimit.”

Me Vendimin nr. 17, datë 26.01.2022, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, të ndryshuar, si më poshtë: 5.2 Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2022 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin kompetencave tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Me Vendimin nr. 326, datë 14.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019 të bordit të ERE-s për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në konstatimet e ERE për shoqërinë “Albgaz” sh.a. sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Me Vendimin nr. 344, datë 21.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të pezullojë vendimarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për shtyrjen e afatit procedural të

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

vendimarrjes së bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror, deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit të munguar.

Me Vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a.

Me Vendimin nr. 352, datë 28.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.04.2023, të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit.”

Me Vendimin nr. 353, datë 28.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 30.04.2023, të depozitohet në ERE Certifikatën e Sigurimit.

Me Vendimin nr. 354, datë 28.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë pikën 5.2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, si vijon: a. 5.2 Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2023 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Miratimi i tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2023 Në zbatim të nenit 17, gërma “e”, të Ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, përcaktohet se “ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave”. Në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit të shoqërisë Albgaz sh.a. për vitin 2023, paraqitjes së planit të investimeve për vitin 2023 si një komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2023, si dhe në zbatim të direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesit në rrjet për përdoruesit e Sistemit të Transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE-s vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019 të bordit të ERE-s për vitin 2023, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., ku përditësimi dhe kompensimi i të ardhurave të kërkuara të shoqërisë Albgaz sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e ALBGAZ.

I. Aksesit në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”:

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ SH.A.

Faqe 15

ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” shoqëria AlbgaZ sh.a ka hartuar dhe dërguar për miratim “Programin e Përputhshmërisë” i cili është filtri/garancia e fundit për garantimin e zbatimit me përpikmëri të dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. AlbgaZ sh.a. ka marrë të gjitha masat për të siguruar akses të barabartë dhe jo diskriminues në sistemin e transmetimit.

2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit.** Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjate vitit 2022 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Aktivitetet e ALBGAZ nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror

3. Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”: **ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.** Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2022, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim i punonjësve të shoqërisë ALBGAZ nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.

C. Politika e informacionit të kompanisë ALBGAZ

ALBGAZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

1. Sigurimi i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”:
ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.

2. Konfidencialiteti i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”:**ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.**

3. Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”:**ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.**

D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 171, datë 16.08.2022, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAZ, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 122/1 Prot datë, 13.11.2023 “kthim përgjigje shkresa nr. 122 prot datë, 17.10.2023”:
ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.

PJESA E DYTË

4. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë

Në raportin e vitit 2022, ALBGAZ duhet të ketë parasysht rekomandimet e më poshtme për përmirësimin e tregut të gazit natyror.

1. Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit.
2. Shqyrtimi i aplikimeve, analiza e kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e gazit natyror për: Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
3. Shtimi i klientëve fundorë.

PJESA E TRETË

6. Detyrat specifike të lëna nga ERE për vitin 2023 dhe objektivat për të ardhmen në sektorin e gazit natyror.

Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, për ecurinë normale të TAP. Përditësimi i të gjitha akteve nënligjore, në përputhje me rregulloret dhe marjen e vendimeve të përbashkëta të nevojshme për to, në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, Komisionit të Rregullimit(EU) 2017/459 (CAM NC) dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të bëjnë me transparencën, diskriminimin e palëve të treta si dhe marjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim.

Bashkëpunimi me TAP AG dhe Entet Rregullatore të Italisë dhe Greqisë për përfundimin me sukses të Testimit të Tregut që filloi në vitin 2021 dhe vazhdojë përgjatë vitit 2022 për zgjerimin e kapacitetit nga 10 miliard m³/vit në 20 miliard m³/vit. Ky testim është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përfundimtar të TAP AG datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, ('Opinionit Përfundimtar i Përbashkët') i Kodit të Tarifave të TAP 6 me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit tek sistemet e transportit të gazit ("CAM NC"). Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e ndryshimeve që po kryhen në Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU si dhe akteve të tjera në lidhje me sektorin e gazit natyror, biogazit, biometanit, hidrogjenit, përdorimit të gazit të lëngëzuar me shkallë të vogël (small scale), përdorimit të gazit metan të komprimuar (KGN) etj.

Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës (MEI) për rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe mundësinë për rezervim të kapacitetit në Fier dhe në Kuçovë, Roskovec i planifikuar për pikat e hyrjes dhe të daljes.

Bashkëpunimi me MEI dhe Albغاز për ndërtimin e tubacionit Fier-Vlorë, lidhja me tubacionin e TAP dhe terminalit të mundshëm që do të ndërtohet nga Exxelarete. Kjo do të shërbejë edhe për futjen e gazit metan në rrjetin e tubacioneve të TAP dhe IAP.

Bashkëpunimi me MEI dhe Albغاز për ndërtimin e tubacionit IAP (Jonian Adriatik Pipline) nga pika e kontaktit me TAP në Fier deri në Kroaci:

Tubacioni Ionian-Adriatic, i cili do lidhet me TAP në një ndërlidhëse në Fier do të përshkojë rreth 170 km në territorin shqiptar, për të vazhduar më tej në veri përmes Malit të Zi, Bosnjë-H. dhe për të përfunduar në Kroaci ku lidhet me sistemit e transmetimit kroat, Plinacro. Kapaciteti do të projektohet për të transmetuar deri në 5 bcm. Parametrat teknikë janë: 32" (pol) për diametrin, 75-85 bar. Projekti i zbatimit ka përfunduar, pritset fillimi i ndërtimit të tij. Kjo do të bëjë që i gjithë rajoni jonë; Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Bosnja-Hercegovina që aktualisht nuk e kanë të zhvilluar tregun e gazit të integrohen në këtë rrjet.

Bashkëpunimi me MIE dhe Albغاز për Seksionin e IAP: Kashar-Mali i Zi. Ky seksion përshkon një gjatësi rreth 86 km, nga Kashari në pikën kufitare me Malin e Zi. Vlera e pritshme e investimit është 165 Milionë EUR. Studimi i Fizibilitetit është kryer, ndërsa në harkun kohor përgjatë viteve

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

2025 deri 2026 parashikohet të kryhen Pre-FEED dhe FEED, për të konkluduar me komisionimin e asetit në vitin 2030.

Bashkëpunimi midis MIE dhe Albgaz për Depozita nentokesore Dumre. Një projekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit është ai i ndërtimit të një vend-depozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë, i cili është parashikuar të realizohet në dy faza, bazuar tek bashkëpunimi mes Albgaz sh.a dhe SNAM, i cili parashikohet të nisë me krijimin e një strukture të ndarë në dy vend-depozitime me kapacitet të kombinuar prej 230 m³ /h gaz, ndërsa faza e dytë parashikon zgjerimin e kësaj strukture deri në kapacitetin e 800 m³/h gaz duke i dhënë kësajsoj dimension rajonal.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Albgaz Sh.a. për Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Dorëzimi për Objektivin e Seksionit Jugor në Fier. TAP do të projektojë, prokurorë dhe ndërtojë pikën e daljes së gazit në Fier, një investim disa milionë Euro në vend, kjo do të bëjë që nëpërmjet kësaj pike të bëhet furnizimi i konsumatorëve të vëndit tonë me gaz.

Bashkëpunimi me MEI dhe Albgaz për periudhën e Testimit të Tregut të vitit 2021, 2022 e në vazhdim mbasi gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit, TAP ka marrë interes kërkesa për kapacitet dhe lidhje në Shqipëri për; pikën e interkonjeksionit në Kuçovë, për pikën e interkonjeksionit në Fier dhe pikën e daljes Roskovec.

Gjithashtu bashkëpunimi me MEI dhe Albgaz për kërkesat e mëposhtme jodetyruese për pikat e lidhjes: një pike dalëse në relievin Roskovec, një pike dalëse në Kuçovë dhe dy (2) kërkesa për pike lidhje në Fier. Zhvillimet në këto pika daljeje do të varen nga koordinimi midis TAP dhe palës kërkuese. MEI është vendimtare në dhënien e të drejtës sipas politikave energjitike që ajo ka. (Ky informacion është vënë në dispozicion të publikut në Raportin e Vlerësimit të Kërkesës të publikuar nga TAP më 25 tetor 2021 dhe raporti tjetër përgjatë vitit 2022).

Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për amendimin e ligjit nr.102/2015 ‘‘Për Sektorin e Gazit Natyror’’, ndryshuar, për plotësimin e kushteve të çertifikimit të Operatorit të Transmetimit të Gazit Natyror, Albgaz sh.a.

Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare në kuadër të sektorit të Gazit CEER (Këshilli Europian i Rregullatorëve të Energjisë). Ku ne jemi vëzhgues si vënd kandidat për në Bashkimin Europian dhe ku kemi kontributin tonë si pjesëmarrës në grupet e punës për ndryshimet ligjore, përmirësimin e direktivave dhe rregulloreve të në sektorin e gazit, Për ruajtjen afatgjatë të energjisë në kushtet e krizës, amendimin e direktivës së efijensës së energjisë, të konsumatorit, strategjinë e energjisë fotovoltaike.

ACER(Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjencia për Kooperim e Rregullatorëve të Energjisë për Europën). ERE është anëtare me të drejta të plota dhe njëkohësisht pjesëmarrës në grupet e punës për: investimet, paqëndrueshmërinë e çmimit të energjisë, prioriteti për konsumatorin, furnizimi me pakicë dhe trajtimi i paqëndrueshmërisë së tregut, dokumenti për shërbimin e LNG me shkallë të vogël etj.

GRI SSE, SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE(GRI SSE, (Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje). Pjesëmarrjet në grupet e punës për tregun e gazit me shumicë, tregun me pakicë, zbatimin e kodit të rrjetit, konjeksione, tarifin në rrjetin e transmetimit , shpërndarjes dhe në kufij, planet 10-të vjeçare etj.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

MEDREG, Working Group Gas Natural, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut. Pjesëmarja jonë në studimet rajonale si: infrastruktura e rajonit të mesdheut, integrimi i i infrastrukturës së mesdheut me atë europian, çmimet me pakicë dhe shumicë, bashkëpunimi me studimet e ECBR në Vienë.

ENTSO-G (Observër në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit Europian të gazit). Pjesëmarja jonë në grupet e punës për studime të përbashkëta.

IGU (Unioni Ndërkombëtar i Gazit).

OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) me qendër në Francë. Jemi anëtarë me të drejta të plota dhe pjesëmarrës në studime rajonale që organizohen prej saj.

UfM (Unioni për rajonin e Mesdheut). Jemi anëtarë me të drejta të plota dhe pjesëmarrës aktivë në grupet e punës të organizuar për probleme të tregut të gazit dhe kjo është pjesë e OME me qendër në Paris.

ECRB, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vendeve të Komunitetit të Energjisë, marja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

PJESA E KATËRT

7. Konkluzione

Raporti i parashtruar përcakton se, në vitin 2022 (viti i pestë i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë dhe raportimit mbi programin bazë), ALBGAZ në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga OST me certifikimin e tij si operator i pavarur i transmetimit të gazit natyror, shoqëria ka bërë përpjekje dhe është angazhuar në përmbushjen e kushteve të pavarësisë së shoqërisë si dhe trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit në drejtim të transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë përdoruesit në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator që drejton sektorin e gazit natyror.

Gjatë vitit 2022 ERE ka patur korrespondencë të vazhdueshme me stafin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., për ndjekjen e objektivit për krijimin e një rrjeti të kompletuar dhe adekuat me kërkesat dhe kushtet e vendosura nga dokumentat e marrëveshjeve ndërqeveritare, me qëllim 5-fishimin e gjatësisë së tubacioneve dhe lidhjen e tij me rrjetin ndërkombëtar të gazit në rajon, e cila mbetet një ndër sfidat kryesore edhe për vitin 2023.

Gjatë vitit 2023 do vijojë korrespondenca dhe bashkëpunimi me shoqërinë “Albgaz” sh.a. për plotësimin e detyrës së caktuar dalë nga konkluzionet e raportit të monitorimit të ERE, për evidentimin e aseteve në terren dhe gjendjen e tyre, si dhe për projektet dhe marrëveshjet që lidhen me krijimin dhe/ose përmirësimin e infrastrukturës së Gazit Natyror.

Raporti i vitit 2022 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje apo nuk konstaton që ALBGAZ të ketë shkelur apo të mos ketë plotësuar kërkesat për përputhshmërinë e kompanisë.

Në kushtet që ndodhet tregu i gazit në vënd, zhvillimi i aktivitetit të ALBGAZ dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rëndë si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohen gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, sëbashku me shtrirje kohore të zgjeruara.

Projektet e targetuara nga ALBGAZ gjatë kësaj periudhe, ka operuar në një kohë kur gazi natyror nuk konsiderohej burim tranzitor drejt objektivit për sigurimin e energjisë së gjelbër dhe për rrjedhojë ishte jashtë agjendës evropiane, duke bërë që burimet për financimin e projekteve në fushën e transmetimit të gazit të kufizoheshin në mënyrë drastike. Por siç theksuam më lart situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë riktheu vëmendjen tek gazi natyror duke rikonsideruar atë si një burim tranzitor energjie, ndaj ky fakt lidhet ngushtësisht me nevojën tonë imediate të brendshme për diversifikim të burimeve energjitike.

Për këtë arsye Albgaz, dhe në ndërveprim me aktorë të tjerë të konsoliduar në Evropë e më gjërë, janë angazhuar në krijimin e një hub-i rajonal në Vlorë. Synimi është bashkërendimi i përpjekjeve dhe ndarja e roleve të secilit aktor në këtë konfigurim të sektorit të gazit i cili i përgjigjet jo vetëm sfidave energjetike në rang kombëtar por edhe në rang rajonal. Në vijim do të renditen sipas prioritetit projektet, pjesë e të cilës është Albgaz, në rolin si operator i kombinuar i gazit, investitor apo si partner strategjik.

1. Terminali GNL në Vlorë. Tubacioni i terminalit Vlore-Fier (Interkoneksioni me TAP)
2. Hub-i Vlorës (nyja) parashikon që Terminali GNL të shërbejë si pikë furnizimi ndërmjet gazit të

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2022

lëngëzuar dhe konsumatorëve. Për këtë qëllim, krahas pranisë së një konsumatori kyç siç është TECi Vlorës, sasi të konsiderueshme gazi duhen të kontraktohen nga furnizues (shippers) nëpërmjet një tubacioni që lidh terminalin me një ndërlidhëse të TAP.

3. Ionian Adriatic Pipeline (IAP) Seksioni i IAP: Fier-Kashar Tubacioni Ionian-Adriatic, i cili do lidhet me TAP në një ndërlidhëse në Fier do të përshkojë rreth 170 km në territorin shqiptar, për të vazhduar më tej në veri përmes Malit të Zi, Bosnjë-H. dhe për të përfunduar në Kroaci ku do të lidhet me sistemit e transmetimit kroat, Plinacro.
4. Depozita nëntokësore Dumre, është një projekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit është ai i ndërtimit të një vënddepozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë
5. Interkoneksioni me RMV, është një projekt me rëndësi është edhe ndërlidhja ndërmjet sistemeve të transmetimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Me gjatësi rreth 60 km, ky investim do të kryhet nga ana e Albgaz sh.a. Gazifikimi i qytetit të Korçës, qyteti i Korçës si një qytet me klimë relativisht të ftohtë ngrohet kryesisht me dru zjarri dhe një pjesë e vogël me energji elektrike.

Ritheksoj faktin se përmbushja e kriterëve të përcaktuara në programin e përputhshmërisë kërkon një bashkëpunim me të ngushtë dhe të vazhdueshëm të organeve drejtuese si dhe të stafit të shoqërisë me zyrтарin e përputhshmërisë, duke synuar identifikimin dhe shmangien në të ardhmen të rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj perdoruesve të sistemit të transmetimit, ruajtjen e të shoqërisë me zyrтарin e përputhshmërisë, duke synuar identifikimin he shmangien në të ardhmen të rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj perdoruesve të sistemit të transmetimit, ruajtjen e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar si dhe pavarësinë e stafit drejtues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë në shmangien e konfliktit të interesit gjate ushtrimit te detyres se tyre. Ndërgjegjësimi i stafit të shoqërisë mbi programin e përputhshmërisë dhe respektimi i detyrimeve të përcaktuara në të, të monitoruara prej zyrтарit të përputhshmërisë do të ndihmojë në krijimin e një kulture korporative mbi çështjet e përputhshmërisë.

Tiranë, 22.12.2023

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ Sh.a

